

RAPORT JOTEKNIK

FABRIKE PER PRODHIM SFUNGJERI

Subjekti: WORLD FOAM SHPK

NIPT: L23415801B

**Adresa: Shtodher, lagjia Nr.5, rruga "Princat Topia", objekt 1 katesh
Z.K.Nr.3427, Kavaje, Tirane**

✚ Instalimi dhe aktiviteti i tij

Subjekti **"WORLD FOAM" SHPK** kryen aktivitetin per **"Fabrike per prodhim sfungjeri"**. Eshte i regjistruar ne QKB me date **15/10/2012** me **Forme Ligjore si: Person Juridik** me **Administrator Z. Donald Krali**. Ky subjekt ushtron aktivitetin e tij ne adresen: **Tirane, Kavaje, Helmes, Fshati shtodher, Rruga Princat Topia**.



Qellimi i ketij subjekti ka qene dhe mbetet permbushja kerkesave te cilesise dhe per ndiqet dhe zbatohet me rigorozitet menaxhimi i cilesise ne te gjitha hallkat e saj. Subjekti ka siguruar staf dhe pajisje profesionale per zhvillimin e ketij aktiviteti. Vendosja e ketij instalimi ne kete zone eshte e pershtatshme per zhvillimin e ketij aktiviteti pasi zona nuk ka objekte apo vepra hidroenergjitike dhe nuk shkaktohet shqetesim per zonat e banuara te ndodhura prane vendit te ushtrimit te veprimtarise se tij. Aktiviteti zhvillohet ne nje ambient te pershtatshem duke mos krijuar keshtu deme apo efekte negative te ndryshme ne mjedisin perreth. Brenda objektit ku subjekti kryen aktivitetin e tij jane te vendosura:

- Mjetet e punes dhe pajisjet per prodhimin e llojeve te ndryshme te sfungjerit.

- Mjediset e zyrave dhe ato higjenosanitare.
- Magazina per tharjen e sfungjerit.
- Magazina per vendosjen e produkteve perfundimtare te sfungjerit qe jane gati per shitje.
- Subjekti disponon edhe hapsiren per mjetet e ngarkim-shkarkimit te lendes se pare si dhe terheqjen e produkteve perfundimtare per shitje.

Pamje te ambienteve te punes se subjektit



- **Lëndët e para dhe ato ndihmëse, substancat e tjera dhe energjia e përdorur ose e gjeneruar nga instalimi;**

Subjekti "WORLD FOAM" SHPK, perdor si **lende te pare**:

Lendet e para jane bartes te cilesive te produktit. **Materialet ndihmese** ose ndryshe **Materialet shtese** e përmirësojnë cilësinë dhe qëndrueshmërinë e produktit perfundimtar. Subjekti per prodhimin e llojeve te ndryshme te sfungjerit perdor si **lende te pare**:

- ***Polioli***
- ***TDI***
- ***MeCl₂***
- ***Uji***

dhe **lende te tjera ndihmese**:

- **T-9**
- **Amine**

- Silikon
- Kolor

Produkte perfundimtare te perftuara pas kryerjes se procesit teknologjik jane:

- ***Sfungjer i llojeve dhe permasave te ndryshme***

Energjia dhe uji, te tjera lende te para, energjia perdoret per venien ne pune te makinerive e pajisjeve te punes gjate procesit teknologjik te prodhimit te sfungjerit si dhe per ndricimin e ambienteve te brendshme te aktivitetit. Uji si lende e pare perdoret per ne prodhim ne sasi prej 1.12% sasi shume e vogel e paperfillshme.

- **Burimet e shkarkimeve nga instalimi;**

Shkarkimet e gazta

Referuar natyres se procesit nga fabrika e prodhimit te sfungjerit, nuk kemi sasi gazrash te shkarkuara ne atmosfer, por vetem emetime te pluhurave por jo ne sasi te madhe. Keto jane minimale dhe numri i njerezve te ekspozuar nga to eshte teper i kufizuar, sepse zonat e banuara ndodhen larg dhe numri i punonjesve, qe kryejne keto procese eshte teper i vogel. Gazerat prej mjeteve te punes jane ne intervale kohore te shkurtera, brenda normave te lejuara pa ndonje ndikim negativ ne mjedisin perreth. Gjate ushtrimit te aktivitetit te fabrikes nuk ka emetime te ndryshme kimike, te cdo lloj qofshin ato. Theksojme se fabrika eshte larg zonave te banuara dhe shtepive te banimit me te aferta.

Rruget ekzistuese te aksesit apo nevoja per hapje te rrugeve te reja

Per zhvillimin e aktivitetit te kesaj fabrike nuk eshte nevoja e hapjes se rrugeve te reja pasi infrastruktura eshte ekzistuese, dhe aktiviteti ndodhet ne nje vend te tille ku kufizohet ng ate 4 anet me rruge.

Shkarkimet e ujerave te ndotura dhe mbetjeve te ngurta

Ushtrimi i ketij aktiviteti ne kushte optimale nuk ndikon ne nivelin e ujerave tokesore, ne rruget ujore, dhe ne rrjedhen e ujerave nentokesore, pasi nuk ka ndotje te ujit nga, derdhje aksidentale dhe substanca kimike te tjera, pasi ato nuk perdoren ne teknologjine e aplikuar ne kete aktivitet. Gjithashtu kompania ka marre masa te ndertoje dhe te mbaje ne kontroll kanalet e kullimin te ujerave dhe reshjeve atmosferike, per te shmangur erozionin. Persa i perket mbetjeve gjate kryerjes se proceve teknologjike nuk do te ket perdorim uje ne procesin teknologjik, ne kushtet e krijuara nuk eshte e nevojshme te merren masa suplementare per mbrojtjen e mjedisit. Ne rast rrjedhje vajrash apo nafte ne sheshin para fabrikes nga mjetet e transportit subjekti duhet te realizoje pastrim te mases se ndotur me keto papasterti. Kurse persa i perket ujerave sanitare ato do te shkarkohen ne rrjetin e kanalizimeve te zones.

- **Kushtet në vendndodhjen e instalimit dhe rastet e njohura historike të ndotjes;**

Procesi teknologjik i kesaj fabrike eshte ai i prodhimit te sfungjerit. Ne afersi te ketij aktiviteti nuk ka objekte te nje rendesie te vecante, ato ndodhen ne distance te konsiderueshme.

- **Natyra dhe sasi të e shkarkimeve të pritshme nga instalimi në çdo vend/mjedis, si dhe identifikimi i efekteve të rëndësishme të shkarkimeve në mjedis;**
- **Shkarkimet ne mjedis dhe prodhimi i mbetjeve**

Zhvillimi i aktivitetit do të sjell emetime të pluhurave ne mjedis nga mjetet e transportit, burime të tjera ndotese për ajrin nuk do të ketë. Pajisjet që do të përdoren për procesin teknologjik do të jenë bashkohore dhe në gjendje të mirë teknike në mënyrë që të shmangen emetimet nga djegia e lendeve djegëse që ato përdorin. Në vendet e caktuara në projekt (depozitat e lendeve të pare) parashikohet depozitimi i materialit të përdorshëm dhe përpunimi i tij për të mundësuar prodhimin e sfungjerit.

Karakteristikat e ndikimeve negative në mjedis

- **Metoda e zbatuar për parashikimin e ndikimeve negative në mjedis**

Për vlerësimin e ndikimeve në mjedis të projektit u ndoqen hapat e më poshteme:

- Njohja me projektin dhe teknologjinë e tij.
- Njohja me natyrën e operacioneve të nevojshme në mjedis.
- Njohja me vlerën natyrore dhe mjedisore të zonës dhe vendit ku ndodhet fabrika.
- Njohja me infrastrukturën egzistuese.
- Njohja me lëndet e para që do të përdoren për zbatimin e projektit.

Duke njohur teknologjinë, operacionet në terren dhe proceset teknologjike u identifikuan ndikimet e mundshme negative në çdo receptor - përberës të mjedisit në këto aktivitete.

Identifikimi i ndikimeve – Përmes të cilit u përcaktua ndërpërimi mjedis-projekt i prodhimit të sfungjerit, dhe u identifikuan ndikimet e mundshme gjatë kësaj faze sipas receptorëve të mjedisit.

Vlerësimi i ndikimeve – Ekspertët mjedisore të fushave të ndryshme bënë përpjekje për matjen e gravitetit të ndikimeve. Vlerësimi i Sinjifikancës ka të bëjë me vetë rëndësinë e ndikimeve dhe është faza më e rëndësishme për zbatuesit e projektit sepse argumenton çdo ndikim negativ dhe përfaqëson atë me objektivisht me tërësinë e bashkëveprimeve midis projektit dhe mjedisit. Kriteret e përdorura për vlerësimin e rëndësisë së ndikimeve variojnë dhe drejtohen kryesisht nga vlerat e mjedisit të ndikuar.

- **Shtrirja fizike dhe kohezgjatja e ndikimeve të identifikuar (Shkalla)**

Shtrirja fizike- Vlerëson sipërfaqen apo dimensionin hapësor të një ndikimi të dhënë në raport me burimin që gjeneron atë ndikim, p.sh. ndikimi në ajër nga procesi teknologjik i prodhimit të sfungjerit është një ndikim saktësisht i përcaktuar i cili mund të matet, me aparaturo nga subjektet e licencuara.

- **Kohezgjatja e ndikimit** – Vlerëson se sa do të zgjase një ndikim i caktuar në dimensionin kohë (ndikim i përhershëm apo i perkoshëm). Në rastin të fabrikës për prodhimin e sfungjerit është i përhershëm për atë kohë sa do të ekzistojë edhe aktiviteti. Ndërsa të gjitha ndikimet e tjera negative në mjedis janë të perkoshme, si shkarkimet e ujit të rreshjeve, gjelberimit, etj.

-Kthyeshmeria –Vlerëson mundësinë e kthimit të mjedisit të ndikuar në gjendjen e tij të më parëshme (aftësia për tu rehabilituar dhe regjeneruar).

-Rendesia – Realizon nje vleresim total te tre permasave te mesiperme dhe njekohesisht thekson vemendjen qe duhet patur per administrimin e ndikimit.

Ndikimet e parashikuara nuk kane shtrirje te madhe fizike, objekti i shfrytezimit ndodhet ne distance te konsiderueshme nga zona me e afert e banuar dhe nuk preket nga zhvillimi i ketij aktiviteti. Zhurmat qe krijohen gjate procesit te punes per prodhimin e sfungjerit nuk perbejn ndotje akustike. Analiza e frekuences te zhurmes te emetuar nga keto makineri dhe pajisje tregon se ato ndodhen nen mesataren e frekuences 100 – 150 Hz, e cila eshte e pranueshme nga veshi i njeriut . Koha ne te cilen do te jene te pranishme keto zhurma eshte vetem gjate dites, meqenese ne kete aktivitet do punohet vetem me nje turn. Niveli i zhurmave ne largesi nuk do te jete i madh dhe do te jete konform normave ne fuqi.

Një përshkrim për shkarkimet e mundshme në mjedis, të tilla si: ujëra të ndotura, gaze dhe pluhur, zhurma, vibrime, si dhe për prodhimin e mbetjeve;

Pershkrim i ndikimeve të mundshme negative në **tokë**

Nga ushtrimii ketij aktiviteti nuk ka ndikime ne toke.

Pershkrim i ndikimeve të mundshme negative në **ajër**

Nr.	Ndikimi i mundshem	Pasoja ne mjedis
1	Shkarkim i sasise minimale te gazeve nga automjetet	Sasia e gazeve NO ₂ dhe SO ₂ qe do te shkarkohet eshte standard i teknologjise se automjeteve qe do te perdoren gjate transportit te lendes se pare dhe punimeve ne sheshin e depozitimit.
2	Emetim zhurmash nga automjetet e transportit dhe mjetet e punes ne brendesi te fabrikes	Objekti eshte i distancuar nga qendrat e banuara, keshtu qe rritja e nivelit te zhurmave nuk do te krijojte probleme per banoret. Gjithsesi operacionet e punes do te jene ne ambiente te brendshme dhe nivelet e zhurmave jane Brenda noremes se lejuar.

Pershkrim i ndikimeve të mundshme negative në **biodiversitet**

Nr.	Ndikimi i mundshem	Pasoja ne mjedis
1	Shqetesim i faunes ne zone	Nga ushtrimi I ketij aktiviteti nuk do te kete shqetesim te faunes se zones pasi se pari aktiviteti ndodhet ne ambient privat ne te cilin nuk ka faune te eger as ne hapsirat perreth aktivitetit nuk jane te pranishme.

Pershkrim i ndikimeve të mundshme negative në **pejsazh**

Nr.	Ndikimi i mundshem	Pasoja ne mjedis
1	Ndikime ne pejsazh	Nuk do te kete ndikime ne paisazh pasi ambientet ku do te ushtrohet aktiviteti jane ekzistuese dhe ne emer te vet subjektit.

Mbetjet e ngurta

Nr.	Ndikimi i mundshem	Pasoja ne mjedis
1	Gjenerim i mbetjeve nga aktiviteti njerezor dhe nga procesi i prodhimit	Kartona, ambalazhe dhe qese plastike nga ambalazhet e ushqimeve dhe aktiviteti i punonjesve, dhe bidona plastike nga lenda e pare qe perdoret ne procesin teknologjik.

- **Teknologjia dhe teknika të tjera të propozuara për parandalimin e shkarkimeve ose, kur kjo nuk është e mundur, për pakësimin e shkarkimeve nga instalimi, veçanërisht duke zbatuar teknikat më të mira të disponueshme;**

Mundesia e zbutjes se ndikimeve dhe argumentimet perkatese nese per ndikime te caktuara nuk mund te zbatohen/ ndermerren masa zbutese

Per te ulur ne minimum ndikimet nga zhurmat do te merren keto masa:

Mjetet e punes, te transportit te lendes se pare do te jene bashkekohore qe plotesojne standartet shteterore, te pajisura me marmite selenciatore te pakesimit te zhurmave.

Per te ulur me tej ndikimin nga zhurmat puntoret detyrimisht do te perdorin paisjet e mbrojtjes ne pune "kufje" ne rast se do te jete nevoja.

Brenda zones se fabrikes se prodhimit te sfungjerit vlerat e zhurmave jane gjithmone poshte normave te lejuara. Jane bere matje te nivelit te zhurmave ne disa objekte te ngjashme ku perdoren te njejat makineri dhe del se ne distancen 10m nga makinerit zhurmat arrijne nivelin 70 dB. Emetimet ne ajer perfaqsohen nga pluhuri qe krijohet gjate levizjes se makinerive ne territorin e fabrikes ndersa ndikimi nga gazet shkaktohet nga mjetet motorrike qe levizin ne ambientet e fabrikes.

Ne projekt per mbrojtjen nga pluhuri do te merren keto masa

Per te eliminuar pluhurin ne kohe te thate qe krijohet gjate levizjes se mjeteve te transportit, transportit ne ambientet e aktivitetit, territori i jashtem i aktivitetit do te sprucohet me uje.

Per mbrojtjen nga gazet e motoreve dizel do te merren keto masa

Mjetet motorrike do te jene bashkekohore qe plotesojne standartet shteterore. Ato do te jene te pajisura me marmita me katalizatore per kapjen e gazeve toksike. Meqenese qendrat e banuara jane ne nje distance relativisht te larget nga zona e aktivitetit ne fjale, keto emetime nuk ndikojne ne to. Gjithashtu nuk do te kete ndikim tek punonjesit e fabrikes, floren dhe faunen per rreth saj. Per zbutjen e ketyre ndikimeve mbi punonjesit e fabrikes ata do te pajisen me mjete mbrojtese nga pluhuri dhe gazet nese do te jete e nevojshme.

Zonat e ndjeshme ndaj ndikimeve te projektit (zona te mbrojtura dhe habitate, qendra te banuara, burime ujore, zona arkeologjike etj).

Si rezultat i zbatimit te projektit ne kete zone nuk ka ndikim negativ mbi ndertimet, trashegimine arkitektonike dhe historike, tiparet arkeologjike dhe mbi vepra te tjera njerezore, sepse ne kete zone dhe perreth saj nuk ka asnje objekt te nje rendesie te vecante te karaktereve te lartpermendura.

- **Alternativën në lidhje me zgjedhjen e vendit të instalimit dhe teknologjinë e përdorur;**

Theksojme per organet vendim marrese, se mundesia e alternativave te marra ne konsiderat per perzgjedhjen e vendodhjes se projektit nga subjekti WORLD FOAM ka ardhur si rezultat i pronesis dhe objekteve te ndertuara ne te cilat jane me leje dhe me dokument pronesia.

- **Masat për parandalimin dhe rikuperimin e mbetjeve (nëse është e nevojshme);**

Zhvillimi i aktivitetit nuk do te sjell emetime te pluhurave ne mjedis gjate zhvillimit te tij, burime te tjera ndotese per ajrin nuk do te kete. Pajisjet qe do te perdoren per transportin e lendes se pare do te jene bashkohore dhe ne gjendje te mire teknike ne menyre qe te shmangen emetimet nga djegia e lendeve djegese qe ato perdorin.

Gjatë zbatimit të projekteve në terren duhet të mbahen në konsideratë mbrojtja e mjedisit dhe standartet mjedisore si dhe të aplikohen masa konkrete. Çdo zbatim projekti duhet të shoqërohet me planin e masave për mbrojtjen e mjedisit dhe shmangien e dëmeve mjedisore të panevojshme dhe të pariparueshme. Masat per mbrojtjen e mjedisit duhet të planifikohen dhe zbatohen gjatë operacioneve me ndikim në mjedis si në fazën përgatitore ashtu edhe atë të shfrytëzimit të vendburimit. Në këtë seksion do të trajtohen masat kryesore për mbrojtjen e mjedisit dhe zbutjen e ndikimeve negative të identifikuara në seksionin paraardhës. Masat e propozuara lidhen me fazat dhe aktivitetin e fabrikes se prodhimit te sfungjerit si me mëposhtme:

- Faza e kryerjes se proceseve teknologjike ne fabrike.
- Aktivitetin jetësor të punëtorëve gjatë punimeve ne fabrike tij

Pershkrim i ndikimeve të mundshme negative në **tokë**

Sic e kemi permendur edhe me siper nga ky aktivitet nuk do te kete ndikime ne toke.

Pershkrim i ndikimeve të mundshme negative në **ajër**

Nr.	Ndikimi i mundshem	Pasoja ne mjedis
1	Shkarkim i sasise minimale te gazeve nga automjetet	Sasia e gazeve NO ₂ dhe SO ₂ qe do te shkarkohet eshte standard i teknologjise se automjeteve qe do te perdoren gjate transportit te lendes se pare dhe punimeve ne sheshin e depozitimit.
2	Emetim zhurmash nga automjetet e transportit dhe mjetet e punes ne brendesi te fabrikes	Objekti eshte i distancuar nga qendrat e banuara, keshtu qe rritja e nivelit te zhurmave nuk do te krijojte probleme per banoret. Gjithsesi operacionet e punes do te jene ne ambjente te brendshme.

Pershkrim i ndikimeve të mundshme negative në **biodiversitet**

Nr.	Ndikimi i mundshem	Pasoja ne mjedis
1	Shqetesim i faunes ne zone	Ambjenti ku do te kryhen punimet, rrjedhimisht proceset ekologjike jane minimale dhe te kufizuara. Dhe pse aktiviteti do te kryhet ne ambjent private ne pronesi te vet ne te cilen nuk eshte e zhvilluar bota faunistike.

Pershkrim i ndikimeve të mundshme negative në **pejsazh**

Nr.	Ndikimi i mundshem	Pasoja ne mjedis
1	Ndikime ne pejsazh	Nuk do te kete ndikime ne paisazh pasi ambjentet ku do te ushtrohet aktiviteti jane ekzistuese dhe nuk do te kete ndertime te reja.

Mbetjet e ngurta

Nr.	Ndikimi i mundshëm	Pasoja ne mjedis
1	Gjenerim i mbetjeve nga aktiviteti njerëzor dhe nga procesi i prodhimit	Kartona, ambalazhe dhe qese plastike nga ambalazhet e ushqimeve dhe aktiviteti i punonjesve, dhe bidona plastike nga lenda e pare qe do te perdoret ne procesin e prodhimit te sfungjerit.

Masat për mbrojtjen e ajrit

Proceset që mund të shkaktojnë pluhura në mjedis agentët atmosferikë si era mund të ngrënë sasi të konsiderueshme pluhuri nga ambientet e jashtme të fabrikës sidomos në vendet e pa asfaltuara prandaj në mot të thatë dhe me erë nevojitet të sperkatet sipërfaqet e jashtme të fabrikës (kjo në varësi edhe të ekspozimit të vendit ku do të ashtrohet aktiviteti i prodhimit të dyshekeve ndaj qendrave të banuara). Skapamentot e automjeteve të transportit qofte të lëndes së pare qofte të asaj perfundimtare duhet të kenë në gjendje funksionale filtrat e tyre teknologjikë të kapjes së grimcave (skapamentot e makinerive kanë një jastëk të posatshtëm për këtë gjë). Përdorimi i karburantit me përmbajtje të ulët squfuri. Qarkullimi i automjeteve në qendrat e banuara të bëhet me shpejtësi të ulët gjë që shmang jo vetëm aksidentet por edhe krijimin e pluhurave.

Gjatë transportit të lëndes së pare krijohen gaze si CO_x dhe NO_x të cilët mund të kenë efekte negative dhe me pasojë sidomos në jetën e punonjesve. Megjithatë nuk parashikohen çlirime të medha gazesh nga operacionet e punës, megjithatë në kohe të thate dhe me erë do të operohet me lagjen e shesheve të punës, lëndes së pare për të bërë të mundur eliminimin e ndotjes së ajrit.

Automjetet që do të përdoren për transport do të shkaktojnë çlirim të zhurmave në mjedis. Sipas limiteve të vendosura nga shteti i BE vlerat e caktuara limit të ekspozimit ditor janë 85 dB dhe vlera maksimale ekspozimi 140 dB. Manikeritë duhet të mirëmbahen teknikisht që zhurma e tyre të jetë vetëm ajo teknologjike dhe jo e avarive. Ato duhet të përdoren me efikasitet dhe të minimizohet koha gjatë së cilës mbahen ndezur motorët. Të mënjanohet rënia e borive të automjeteve nga shoferët për të mos krijuar zhurmë dhe stres tek banorët.

Administrimi i mbetjeve (urbane)

Mbetjet e gjeneruara nga aktiviteti jetësor i punëtorëve apo ambalazhet do të grumbullohen nëpër kontenier të posacem të vendosur në ambientet e fabrikës dhe në fund të ditës së punës do të transportohen drejt vendeve me të afërta të caktuara nga Pushteti Vendor. Bidonat plastike të lëndes së pare do të grumbujllonin e do të terhiqen me pas nga kompania prodhuese e lëndes së pare për tu riperdorur.

Ujërat e ndotur që do të prodhohen nga aktiviteti njerëzor si ujërat e tualeteve do largohen për në rrjetin e kanalizimeve.

- **Masat për përdorimin eficient të energjisë;**

Subjekti ne fjale do te furnizohet me energji elektrike nga rrjeti. Makinerite dhe mjetet e procesit teknologjik funksionojne me energji elektrike, ndersa mjetet e ngarkimit shkarkimit dhe te transportit perdorin lende djegese te lenget gasoil. Theksojme se perdorimi i ketyre burimeve nuk ka ndikim ne zone, sepse sigurohen sipas procedurave dhe nga subjekte te licensuara.

- **Masa të tjera të planifikuara në përputhje me parimet e përgjithshme që rregullojnë detyrimet themelore të operatorit, dmth:**

- a) janë marrë masat e nevojshme për të parandaluar aksidentet dhe për të kufizuar pasojat e tyre;
- b) janë ndërmarrë masat e nevojshme, me ndërprerjet definitive të aktiviteteve, për të shmangur ndonjë rrezik të ndotjes dhe kthimin e vendit të operimit në gjendje të kënaqshme;

Rreziqe me pasoja ne mjedis

Renien e ndonje zjarri ne ambientin e prodhimit te sfungjereve.

Rreziqet me pasoja ne mjedisin human dhe ekonomik

- Aksidentet e punonjesve gjate procesit teknologjik ne fabrike.
- Aksidentet si pasoje e renies se zjarrit.

Probabiliteti i ndodhjes per secilin nga rastet e me siperm do te varet shume nga masat mbrojtese qe do te parashikohen dhe zbatohen. Zhvillimi i aktivitetit nuk shoqerohet me aksidente te cilat mund te sjellin pasoja te demshme ne mjedis si ndotje te ujerave nga lende te rrezikshme, emetime ne ajer nga gaze helmuese apo kontaminim te tokes.

- **Monitorimi i planifikuar i shkarkimeve nga instalimi.**

Subjekti do te monitoroje aktivitetin e e prodhimit te sfungjerit ne disa drejtime sipas nje programi te hartuar per kete qellim. Ne pergatitjen e programit te monitorimit mjedisor merret ne konsiderate mundesia e realizimit te nje monitorimi te elementeve me ndikim ne mjedis. Vetemonitorimi aktivitetit nga subjekti do te behet per ata elemente qe parashikohet se kane ndikim negativ ne mjedis. Te dhenat e marra nga monitorimi do te evidentohen ne regjistrin perkates dhe me rezultatet e matjeve do te informohen organet e administrimit te mjedisit ne qender dhe ne qark. Te dhenat cilesore, sipas tabelës do te hidhen ne nje regjister qe administrohet nga vete kompania dhe do te dorezohen ne AKM dhe DRM sa here eshte e nevojshme, sipas procedurave ligjore dhe rregulloreve.

Me **VKM per programin e monitorimit ne RSH** jepen qarte indikatorët mjedisorë që monitorohen, megjithatë këta indikatorë duhet të përkasin veprimtarisë. Qëllimi i monitorimit mjedisor për veprimtarinë e projektit të zbatuar është që të sigurojë të dhëna nëpërmjet të cilave të vlerësohet nëse operimi i veprimtarisë është në përputhje me ligjet dhe standartet mjedisore që lidhen me të, si dhe për të vlerësuar performancën mjedisore të menaxhimit të saj në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm.

Nr	Elementi i monitorimit	Frekuenca
1	Monitorim i zhurmave të procesit teknologjik dhe të transportit, dhe gjatë levizjes pranë qendrave të banuara.	Vazhdimisht
2	Monitorim i pluhurave në proceset e transportit, veçanërisht në rrugët e pa asfaltuara.	Ne stinën e thatë dhe kohë me erë
3	Monitorimi i gjendjes së paisjeve e makinerive, veçanërisht mjeteve të transportit dhe mundësive për rrjedhje dhe ndotje.	Vazhdimisht
4	Monitorim i faktorëve që shkaktojnë fatkeqësi natyrore dhe humane.	Vazhdimisht
5	Monitorim i i paisjeve të procesit teknologjik për prodhimin e sfungjerit	Vazhdimisht

Indikatorët e mesipër të monitorimit janë një ndërthurje treguesish me të cilët vlerësohet trysnia që ushtron zbatimi i këtij projekti në mjedisin si dhe gjendja e mjedisit, ndikimit e funksionimit të projektit të zbatuar në këto objekte. Matja dhe mbledhja e të dhënave për treguesit e mesipër do të bëhet konform metodave dhe teknikave shkencore të njohura dhe të pranueshme. Të dhënat që do të mbledhen do të vihen në dispozicion të organeve shtetërore dhe të interesuarve të tjera, gjithashtu këto të dhëna do të analizohen me qëllim përmirësimit të performancës mjedisore të veprimtarisë dhe berjen e korigjimeve të nevojshme. Për të ruajtur të dhënat mjedisore të veprimtarisë do të përgatitet dhe mbahet një regjister i veçantë ku do të hidhen vazhdimisht të dhënat mjedisore.

Administrator
Donald Krali